

VENDIM
Nr.735, datë 1.7.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“UNAZA VERIORE, KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë truall), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza veriore, Korçë”.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 581 (pesëqind e tetëdhjetë e një) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 10 655 540 (dhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 10 655 540 (dhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë në korrik 2009 dhe të përfundojë më 30.9.2009.
7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP, bashkëpronësi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë origjinal të pronësisë, sipas bashkëpronarëve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
9. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.
10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
 “UNAZA VERIORE KORÇË”

N r.	Emri	Atësi a	Mbiem ri	Z. K.	Nr. pasuri së	Lloji i pasurisë			Vlera totale (lekë)	Shënime
						Truall				
						Si p.	Çmi mi	Vlera		
1	Ali		Muço	856 4	3/198	12 7	1834 0	232918 0	232918 0	Konfir.nga ZVRPP
2	Sabri	Xhafa rr	Beshiri	856 4	7//94	2	1834 0	36680	36680	Sipas LN nga ZVRPP
3	Mele q	Alizot	Beshiri	856 4	7//95	5	1834 0	91700	91700	Sipas LN nga ZVRPP
4	Mele q	Alizot	Beshiri	856 4	7//96	10	1834 0	183400	183400	Sipas LN nga ZVRPP
5	Seit	Ajredi n	Beshiri	856 4	7//97	40	1834 0	733600	733600	Sipas LN nga ZVRPP
6	Famil ja		Qelibar i	856 4	7/967	29 0	1834 0	531860 0	531860 0	Konf.bashkëpro nësi ZVRPP
7	Famil ja		Gjysm a	856 4	3/743	10 7	1834 0	196238 0	196238 0	Konf.bashkëpro nësi ZVRPP
		Shum a				58 1		106555 40	106555 40	